

VENDIM
Nr.714, datë 21.5.2008

PËR SIGURIMIN E JETËS SË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA, TË DËRGUARA ME MISIONE USHTARAKE JASHTË VENDIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5 të nenit 6 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes e të kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me INSIG, sh.a.-në, të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet në grup, të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të dërguar me misione ushtarake jashtë vendit, me fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2008, të miratuara për këtë ministri.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe INSIG, sh.a-ja për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha